



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:282583

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05873181

KE.nr.417/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “Posta e Kosovës” SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.H. kundër të paditurit N.P.T. “Çlirimi” me numër të biznesit 80123329 i përfaqësuar nga pronari S.D., me adresë në fshatin Korishë, Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, me objekt kontesti, mos përmbushje e kontratës dhe kompensim i dëmit, vlera e kontestit 27,670.74€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 13.06.2023, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 25.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Posta e Kosovës” SH.A., dhe DETYROHET i padituri N.P.T. “Çlirimi” që në emër të kompensimit të dëmit në formën e fitimit të humbur për shkak të mos përmbushjes së kontratës nr. 01-381/12 të datës 30.10.2012, t’ia paguaj paditësit shumën prej 27,670.74€ (njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë euro e shtatëdhjetë e katër cent), me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, me datë 27.02.2014 deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. OBLIGOHET i padituri që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia kompensoj paditësit shumën prej 2,330.00€ (dy mijë e treqind e tridhjetë euro).

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi Posta e Kosovës, me datë 27.02.2014 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentin për Çështje Ekonomike ka parashtruar padi ndaj të paditurit N.P.T. “Çlirimi”, me objekt kontesti kompensimi i dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës nr. 01-381/12 të datës 30.10.2012, me numër të prokurimit PTK 12 122 511 me titull “Renovimi i objekteve regjionale të PTK-së” me numër të referencës FN_LLQ, kontratë kjo e cila përfshinte renovimin e objekteve Lot 3 (Dragash) në vlerë prej 118.433.56€, Lot 7 (Pejë) në vlerë prej 58.462.10€ dhe Lot 9 (Mitrovicë) në vlerë prej 87.700.00€. Përmes padisë paditësi thekson se i padituri gjatë implementimit të kontratës nuk i është përmbajtur kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, si dhe pa kurrfarë baze nuk ka vazhduar ekzekutimin e punimeve në objektin e Postës kryesore në Dragash, Pejë dhe Mitrovicë, duke mos respektuar afatin e paraparë për përfundimin e punimeve. Tutje, thekson se paditësi dhe i padituri kanë lidhur një marrëveshje miqësore për vazhdimin e punimeve dhe planit dinamik, sipas të cilës janë pajtuar edhe për një afat tjetër shtesë për vazhdimin e punimeve dhe në bazë të asaj marrëveshje është arritur pajtimi që përfundimi i postës në Dragash të përfundoj brenda afatit prej 45 ditësh pune duke filluar nga data 27.05.2013, kurse për objektin e postës në Gjakovë dhe Mitrovicë, punimet të përfundojnë brenda afatit prej 7 ditësh, përkatësisht 15 ditë kalendarike duke filluar nga data 23.05.2013. Më tej ka theksuar se përkundër zgjatjes së afatit, i padituri nuk ka arritur të përfundoj në tërësi punimet duke realizuar 30% të punimeve në Dragash dhe Gjakovë dhe 25 % në Mitrovicë.

Lidhur me këtë çështje kontestimore ka vendosur fillimisht Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin I.C.nr.149/2014 të datës 04.07.2017 me të cilin ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërkaq kishte aprovuar si të bazuar kundërpadinë e paditësit me të cilën kishte obliguar paditësin që kundërpaditësit t’ia paguaj 15.075.60€ në emër të borxhit për punët e kryera në emër të kontratës për renovimin e objekteve postare në Dragash, Gjakovë dhe Mitrovicë. Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktvendimit Ac.NR.231/2017 të datës 20.11.2019 kishte aprovuar ankesën e paditësit duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me shenjën I.C.nr.149/2014 të datës 04.07.2017 dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjatë procedurës së rigjyimit, kundërpadia ishte konsideruar e tërhequr pasi që i padituri kundërpaditësi nuk ishte paraqitur për seancën e datës 21.01.2020 ndërsa mungesën nuk e kishte arsyetuar, prandaj Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, e kishte konsideruar të tërhequr kërkesëpadinë e paditësit.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë parashtresave të dorëzuara kësaj gjykatë si dhe pranë deklarimeve nga seancat paraprake, pasi që sipas shkresave të cilat ekzistojnë vërtetojnë se i padituri nuk e ka përmbushur 70% të kontratës, duke i sjellë kështu paditësit dëm financiar dhe fitim të humbur. Më tej ka theksuar se gjatë implementimit të kontratës, i padituri nuk i është përmbajtur kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës si dhe pa kurrfarë baze nuk ka vazhduar ekzekutimin e punimeve në objektin e postës kryesore në Dragash, Gjakovë dhe Mitrovicë, për çka projekti ka mbetur i pa përfunduar. Tutje ka shtuar se me qëllim të përmbushjes së kontratës vazhdimisht i është kërkuar të paditurit kryerja e punëve, mirëpo i njëjti nuk i ka përfillur fare kërkesat e paditësit, madje edhe përkundër afateve i njëjti sërish ka dështuar që të përfundoj punët brenda afatit ligjor. Sipas paditësit kjo i ka shkaktuar dëm financiar, andaj i propozon gjykatës që të aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrohet i padituri që paditësit Posta e Kosovës t'ia paguaj shumën prej 27,670.74€ në emër të dëmit financiar në formën e fitimit të humbur për shkak të mos përmbushjes së tërësishme të kontratës me kamatë ligjore prej 8%. Po ashtu, ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të ekspertizës financiare shumën prej 700€, ekspertizës së ndërtimtarisë shumën prej 500€, taksës për ushtrimin e padisë shumën prej 500€, ekspertizës nga lëmi i ndërtimtarisë shumën prej 600€, si dhe në emër të taksës për ankesë shumën prej 30€, në total shumën prej 2,330.00€.

I padituri përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar. Ka theksuar se paditësi nuk ka kryer obligimet ndaj të paditurit duke ndërprerë në mënyrë të njëanshme kontratën me paditësin. Po ashtu, ka theksuar se heshtja e paditësit ka pamundësuar kryerjen në tërësi të punëve sipas kontratës. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi si të pathemeltë padinë e paditësit.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, i padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve të thëna gjatë shqyrtimit gjyqësor duke kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. Më tej ka theksuar se pas administrimit të provave e sidomos nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë janë pasqyruar raportet reciproke të palëve ndërgjyqëse të cilat kanë rrjedh nga kontrata për renovimin e objekteve të paditësit në Dragash, Gjakovë dhe Mitrovicë si dhe bazuar në sqarimet e ekspertit është vërtetuar se ka pasur vonesa në kryerjen e punëve por të njëjtat kanë ndodhur me marrëveshjen e palëve duke harmonizuar kohen e veprimit. Më tej ka shtuar se personeli i paditësit në njësitë e tija në Dragash, Gjakovë dhe Mitrovicë, gjithnjë ka pasur qasje dhe nuk ka

pasur pengesa për kryerjen e punëve të tyre, e bile edhe në disa raste është konstatuar se ka pasur me shumë të hyra se sa që ka pasur më parë, dhe se sipas ekspertizës i padituri ka kryer punë më tepër se sa është paguar. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi ti të pabazuar padinë e paditësit si dhe ta detyroj paditësin që të paditurit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale në shumë të përgjithshme prej 1,830.40€, më së largu brenda 7 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit dhe atë për përgjigjen ne padi shumen prej 208.00€dhe për 6 përfaqësime në seanca gjyqësore me avokat shumën e përgjithshme prej 1,622.40€ duke e llogaritur shumen prej 270.40 € për një seancë.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: kontrata me numër 01-381/12 e datës 30.10.2012, pjesa 2 e kontratës dhe dokumentacionin teknik i projektit sipas formularit për dorëzimin e tenderit, shkresa e datës 21.11.2013, komunikimi elektronik i datës 05.11.2013, 04.11.2013, 01.11.2013, 19.11.2013, njoftimi për shkëputjen e kontratës e datës 19.11.2013, komunikimi elektronik i datës 11.04.2013, marrëveshja miqësore për zhvillim të planit dinamik e datës 24.05.2013, komunikimi elektronik i datës 11 dhe 14.11.2013, draft marrëveshje miqësore për ndërprerjen e kontratës, komunikimi elektronik i datës 06.06.2013, raporti mbi dëmin financiar dhe fitimin e humbur për mos përmbushjen e kontratës nga operatori ekonomik "Çlirimi", raporti përfundimtar për objektin e zyrës postare në Dragash, raporti për objektin e zyrës postare në Mitrovicë, raporti për objektin e zyrës postare në Gjakovë, fatura me numër 1/Lot 3/12, opinion legal për pagesën e 10% avans sipas kontratës, fatura me numër 2/Lot9/12F, fatura me numër 1/Lot 7/12, fatura me numër 1/Lot 8/12F, fatura me numër 2/Lot 8/12 G, fatura me numër 2/Lot3/13 G, raporti për pranimin e përkohshëm për 30% (situacioni i parë) të punëve të kryera nga kompania "Çlirimi", ekspertiza gjyqësore e ndërtimtarisë, e punuar nga eksperti gjyqësore N.M., raporti plotësues i ekspertizës së ndërtimtarisë, e punuar nga eksperti N.M. me datë 15.05.2017, komunikim elektronik, nëntor 2013, marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të shitjes në mes të PTK SH.A dhe Postës së Kosovës SH.A, raport plotësues i ekspertizës nga lëmi e ndërtimtarisë i datës 12.05.2020, ekspertizë profesionale nga lëmi ndërtimtarisë e hartuar nga eksperti S.B. me datë 10.09.2020, plotësim ekspertize nga lëmi ndërtimtarisë e hartuar nga eksperti S.B. me datë 15.02.2021.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 30.10.2012 kishin hyrë në raport juridik me lidhjen e kontratës me numër 01-381/12, me objekt të kontratës, renovimin e objekteve postare dhe atë në Lot 3 renovimi i objektit postar në Dragash, në vlerë prej 118.433.56€, Lot 7 renovimi i objektit postar në Pejë, në vlerë prej 58.462.10€, Lot 8 renovimi i objektit postar në Gjakovë në vlerë prej 58,462.10€ dhe Lot 9 renovimi i objektit postar në Mitrovicë në vlerë prej 87.700.00€.

Nga komunikimet elektronike të 05.11.2013, 04.11.2013, 01.11.2013, 19.11.2013, gjykata konstaton se paditësi ka komunikuar me të paditurin lidhur me propozimin për shkëputjen e marrëveshjes për Lot 8 dhe Lot 9, për shkak të mos përfundimit në kohë të punëve.

Nga njoftimi për shkëputjen e kontratës e datës 19.11.2013, gjykata konstaton se paditësi kishte njoftuar të paditurin për shkëputje të njëanshme të kontratës për shkak të dështimit të realizimit të kontratës Nr. 01-381/12 të datës 30.10.2012, me numër te prokurimit PTK 12 122 511 me titull “Renovimi i objekteve regjionale të PTK-së” me numër të referencës FN_LL.P.

Nga komunikimi elektronik i datës 11.04.2013, gjykata konstaton se të paditurit i është dhënë afat shtesë për përfundimin e punimeve, dhe atë 20 ditë kalendatike për përfundimin e punimeve në objektin postar në Mitrovicë duke filluar nga data 12.04.2012, 10 ditë kalendatike për përfundimin e punimeve në objektin postar në Gjakovë duke filluar nga data 12.04.2012, 27 ditë kalendatike për përfundimin e punimeve në objektin postar në Pejë duke filluar nga data 12.04.2012, si dhe të njoftohet ndërkohë për afatin e punimeve për përfundimin e punimeve në objektin postar në Dragash.

Nga marrëveshja miqësore për zhvillim të planit dinamik e datës 24.05.2013, gjykata konstaton se të paditurit i është dhënë afat shtesë për përfundimin e punimeve, dhe atë për Lot 3, Renovimi i objektit të PK në Dragash, brenda planit dinamik – 45 ditë pune duke filluar nga data 27.05.2013, Lot 7, Renovimi i objektit të PK në Pejë, brenda planit dinamik – 20 ditë pune duke filluar nga data 24.05.2013, Lot 8, Renovimi i objektit të PK në Gjakovë, brenda planit dinamik – 7 ditë pune duke filluar nga data 23.05.2013 dhe Lot 8, Renovimi i objektit të PK në Mitrovicë brenda planit dinamik – 15 ditë pune duke filluar nga data 23.05.2013.

Nga komunikimi elektronik i datës 11 dhe 14.11.2013, gjykata konstaton se paditësi i ka propozuar të paditurit shkëputjen miqësore të kontratës duke i dhënë afat dy ditor për përgjigje dhe duke e njoftuar se në rast të mos përgjigjes do të bëhet shkëputja e njëanshme për shkak të mos përfundimit të punimeve, si dhe pas mos përgjigjes i është ndërprerë kontrata në mënyrë të njëanshme.

Nga draft marrëveshje miqësore për ndërprerjen e kontratës, komunikimi elektronik i datës 06.06.2013, gjykata konstaton se si pjesë e kësaj marrëveshje ishte paraparë që të paditurit t'i ndalet shuma prej 7,274.65€ për Lot 8 dhe 16,091.00€ për Lot 9 për shkak të vonesave dhe nga përgjigja e të paditurit gjykata konstatoi se i padituri nuk ishte pajtuar me ndërprerjen miqësore të kontratës, ku ndër të tjera theksohet se vonesa nuk ishte shkaktuar nga i padituri por për shkak të pengesave nga paditësi.

Nga raporti mbi dëmin financiar dhe fitimin e humbur për mos përmbushjen e kontratës nga operatori ekonomik "Çlirimi", raporti përfundimtar për objektin e zyrës postare në Dragash, gjykata konstaton se nga i padituri evidentohet se dëmi financiar i shkaktuar si pasojë e mos përmbushjes së kontratës është 52,919.14€ si dhe 21,152.70€ dëmi financiar për pagesat e realizuara të avansit ndërkaq fitimi i humbur i pretenduar në shumë prej 596,486.74€.

Gjykata gjatë gjykimit të parë të mbajtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, në këtë çështje me aktvendimin e marrë me datë 20.06.2016 ka nxjerrë provën përmes ekspertizës nga lëmi e ndërtimtarisë dhe për ekspert ka caktuar, ekspertin N.M. i cili në nëntor të vitit 2016 ka hartuar raportin e ekspertizës ndërsa, sipas parashtrësive për sqarime shtesë të parashtruara nga paditësi dhe i padituri, 15.05.2017 ka bërë plotësimin e ekspertizës nga lëmi e ndërtimtarisë, në të cilin ka vlerësuar se i padituri ka kryer punë në shumë sesa që është paguar dhe atë për 15,075.00€ më shumë sesa që i janë paguar.

Gjykata gjatë rigjykimit të kësaj çështje juridike – kontestimore, përmes Aktvendimit II.Nr.731/19 ka nxjerrë provën përmes ekspertizës nga lëmi ndërtimtarisë dhe për ekspert ka caktuar, ekspertin S.B., i cili më 10.09.2020 ka hartuar raportin e ekspertizës ndërsa përmes aktvendimit të nxjerrë gjatë seancës së datës 13.01.2021 eksperti ishte obliguar të bëjë plotësimin e ekspertizës, ku me datë 10.09.2020 ka bërë plotësimin e ekspertizës, në të cilin ka vlerësuar se i padituri nuk ka qenë i përkushtuar apo nuk ka pasur kapacitet në kryerjen e punëve, nuk ka qenë i rregullt në mbajtjen e rregullt të ditarit, nuk i ka kryer punët me kohë, nuk iu është përgjigjur vërejtjeve të paditësit, si dhe ka mbajtur avansin në lartësi prej 21,152.71€

Gjykata me qëllim të vërtetimit të lartësisë së fitimit të humbur ka nxjerr ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti financiar R.B. me datë 20.03.2022 dhe përmes aktvendimit të nxjerr gjatë seancës së datës 03.05.2024 Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, kishte aprovuar propozimin e paditësit për plotësimin e ekspertizës e cila ishte plotësuar nga eksperti R.B., më datë 10.05.2024, ku konstatohet se fitimi i humbur për shkak të mos përfundimit me kohë të punimeve për Lot 3 është 0.00€, Lot 8 është 10.139.68€ dhe Lot 9 20,659.06€, ndërkaq shuma të cilën vet paditësi e ka zbritur për shkak të mos pagesës së punëve të kryera ka qenë 3,128.00€, nga çfarë ka mbetur dëmi në lartësi prej 27,670.74€.

3. Baza ligjore

Nga faktet e vërtetuara, Gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit mbi Detyrimet i nxjerr nga ish-RSFJ në vitin 1978, i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së raportit kontraktual në mes të palëve, përkatësisht në kohën kur është lidhur Kontrata me numër 01-381/12 e datës 30.10.2012 ka qenë në fuqi Ligji Mbi Detyrimet

Neni 630 i LMD-së përcakton se: *“(1) Kontrata e ndërtimeve është kontratë e sipërmarrjs me të cilën zbatuesi i punimeve obligohet se sipas projektit të caktuar të ndërtojë në afatin e caktuar ngrehinë të caktuar në tokën e caktuar, apo që në një tokë të tillë respektivisht në objektin ekzistues të kryejë punime të tjera ndërtimi, ndërsa porositi obligohet që për këtë t'i paguajë shpërblimin e caktuar. (2) Kontrata e ndërtimeve duhet të lidhet në formë shkresore.”.*

Po ashtu, zbatohen dispozitat e LMD të cilat i referohen zgjidhjes së kontratës për shkak të mos përmbushjes, dhe atë duke iu referuar nenit 124 i cili përcakton se: *“Në kontratat dypalëshe, kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte të parashikuara në nenet e mëpastajmë, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t'i kompensohet dëmi.”*, si dhe nenit 125 ku parashihet se: *“(1) Kur përmbushje e detyrimit në afatin e caktuar është pjesë përbërëse esenciale e kontratës, ndërsa debitori nuk e përmbush detyrimin brenda këtij afati, kontrata zgjidhet me vetë të drejtën. (2) Por, kreditori mund ta mbajë kontratën në fuqi, në qoftë se pas skadimit të afatit, pa shtytje e njofton debitorin se kërkon përmbushjen e kontratës. (3) Në qoftë se kreditori ka kërkuar përmbushjen, por nuk e ka marrë brenda afatit të arsyeshëm, mund të deklarojë zgjidhjen e kontratës. (4) Këto rregulla vlejnë si në rastin kur palët kontraktuese kanë parashikuar që kontrata të konsiderohet e zgjidhur në qoftë se nuk do të përmbushet brenda*

afatit të caktuar, ashtu edhe atëherë kur përmbushja e kontratës brenda afatit të caktuar është pjesë përbërëse esenciale e kontratës sipas vetë natyrës së punës.

Neni 130 i LMD, i cili parasheh se: *“Kreditori i cili për shkak të mospërmbushjes së detyrimit të debitorit e zgjidh kontratën, ka për detyrë që këtë t’ia komunikojë debitorit pa shtytje.”*, si dhe neni 132 par.1, i cili përcakton se: *“(1) Me zgjidhjen e kontratës të dy palët lirohen nga detyrimet e veta, me përjashtim të detyrimit për shpërblimin e dëmit eventual..”*.

Po ashtu, gjejnë zbatim dispozitat mbi krijimin e detyrimeve si pasojë e shkaktimit të dëmit, respektivisht neni 154 par. 1 i cili përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”* Si dhe neni 189 par.1, 2 dhe 3 i LMD-së i cili përcakton se: *“(1) I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë, ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar. (2) Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, me përjashtim të rastit kur ligji urdhëron diçka tjetër. (3) Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta, ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi.”*.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata aplikoi nenin 277 të LMD-së i cili përcakton se: *“(1) Debitori që vonon me përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjësë, edhe kamatin sipas shkallës, e cila në vendin e përmbushjes paguhet në depozitimet e kursimit me të parë.”*

4. Vlerësimet e gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar, për arsye se i padituri për shkak të mos përfundimit të punimeve brenda afatit të përcaktuar me kontratë, i ka shkaktuar paditësit dëm material në formë të fitimit të humbur, duke i pamundësuar shfrytëzimin e objekteve të cilat kanë qenë objekt i kontratës, për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, respektivisht ofrimin e shërbimeve postare.

Sipas vlerësimit të gjykatës, paditësi dhe i padituri kishin hyrë në raport juridiko civil përmes nënshkrimit të kontratës me numër 01-381/12, të datës 30.10.2012, me objekt renovimin e objekteve dhe atë në Lot 3 renovimi i objektit postar në Dragash, në vlerë prej 118.433.56€, Lot 7 renovimi i objektit postar në Pejë, në vlerë prej 58.462.10€, Lot 8 renovimi i objektit postar në

Gjakovë në vlerë prej 58,462.10€ dhe Lot 9 renovimi i objektit postar në Mitrovicë në vlerë prej 87.700.00€.

Gjykata gjeti se përmes kontratës së datës 30.10.2012 dhe Kushteve të Veçanta (KVK) të kontratës palët ishin dakorduar që për Lot 3 objekti në Dragash, fillimi i punëve të nisë me datë 04.10.2012 dhe përfundimi i tyre pas 45 ditësh punë, për Lot 8 objekti në Gjakovë, fillimi i punëve ishte paraparë të nis me datë 04.10.2012 dhe përfundimi i tyre pas 40 ditë pune, ndërkaq për Lot 9 objekti në Mitrovicë, fillimi i punëve ishte paraparë të nisë me datë 04.10.2012 dhe përfundimi i tyre pas 40 ditë pune.

Gjykata gjeti se i padituri nuk kishte arritur t'iu përmbahet afateve të përcaktuara bë KVK, për përfundimin e punimeve, andaj me paditësin kishin arritur një marrëveshje miqësore me të cilën ishte zgjatur afati për përfundimin e punimeve duke i dhënë të paditurit afat shtesë, dhe atë për Lot 3, Renovimi i objektit të PK në Dragash, brenda planit dinamik – 45 ditë pune duke filluar nga data 27.05.2013, Lot 7, Renovimi i objektit të PK në Pejë, brenda planit dinamik – 20 ditë pune duke filluar nga data 24.05.2013, Lot 8, Renovimi i objektit të PK në Gjakovë, brenda planit dinamik – 7 ditë pune duke filluar nga data 23.05.2013 dhe Lot 8, Renovimi i objektit të PK në Mitrovicë brenda planit dinamik – 15 ditë pune duke filluar nga data 23.05.2013.

Gjykata po ashtu, iu referua nenit 26 të kontratës së lidhur midis palëve ndërgjyqëse, ku përcaktohet se deri tek shkëputja e kontratës mund të vije si pasoje e shkeljeve thelbësore, e që në përputhje me dispozitat ligjore të lartcekura, tek kontratat me afat të caktuar mos përmbushja e detyrimeve të kontratës brenda afateve të përcaktuara në kontratë përbën shkelje thelbësore të kontratës.

Gjykata nga provat e administruara respektivisht komunikimet elektronike midis palëve ndërgjyqëse vërtetoi se paditësi vazhdimisht ka kërkuar nga i padituri përfundimin e punimeve dhe funksionalizimin e objekteve postare të cilat kishin qenë objekt i kontratës, madje duke parë pamundësinë e përfundimit të tyre në kohë, paditësi i kishte dhënë të paditurit edhe afat shtesë për përfundimin e tyre, mirëpo i njëjti nuk kishte arritur të përfundonte punimet as pas zgjatjes së afatit, duke dështuar kështu të përmbush kontratën.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme, gjykata gjeti se shkëputja e kontratës së lidhur midis paditësit dhe të paditurit, ishte bërë në mënyrë të njëanshme nga paditësi për shkak të mos përfundimit të punëve brenda afatit të përcaktuar me KVK dhe Planin Dinamik të punës, bazë

kjo e mjaftueshme për shkëputje të kontratës për shkak të mos përmbushjes brenda afatit të përcaktuar me kontratë.

Në këtë drejtim gjykata vlerësoi edhe faktin se në kuptim të nenit 124 të LMD-së, paditësi i kishte dhënë të paditurit një afat shtesë për përmbushjen e obligimeve nga kontrata, mirëpo i padituri edhe pas kalimit të afatit shtesë, nuk kishte arritur t'i përmbush obligimet kontraktuale.

Lidhur me këtë, gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të paditurit për arsyet e mos përmbushjes së kontratës por, gjykata të njëjtat pretendim nuk i gjeti të bazuara në prova materiale dhe nuk arriti të konstatojë se paditësi ka pasur faj në mos përmbushjen brenda afatit të kontratës nga i padituri, andaj në këtë rast gjykata vlerësoi se paditësi ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm mundësimin e realizimit të kontratës dhe lënies së afatit shtesë për përmbushje por që i padituri nuk ka arritur të përmbush kontratën as brenda afateve shtesë, ashtu që paditësit i është shkaktuar dëm në formën e fitimit të humbur.

Mbi këtë bazë, gjykata gjen se gjatë vonesës së funksionalizimit të objekteve postale paditësit i është shkaktuar dëm në formën e fitimit të humbur dhe atë bazuar në konstatimin dhe mendimin e ekspertit R.B. të dhënë në ekspertizën dhe plotësimin e ekspertizës financiare të datës 10.05.2024, lartësia e fitimit të humbur gjatë vonesave në përfundimin e punimeve për Lot 3 është 0.00€, Lot 8 është 10.139.68€ dhe Lot 9 është 20,659.06€.

Sipas vlerësimit të gjykatës, për të ekzistuar detyrimi për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësuar disa kushte, dhe atë të ekzistojnë subjektet e marrëdhënies detyrimore, të ekzistojë fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi, të ekzistojë dëmi i shkaktuar, të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe pasojës, si dhe të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit. Në këtë drejtim gjykata gjeti se janë plotësuar në mënyrë komulative të gjitha kushtet për shpërblimin e dëmit andaj, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, që paditësit t'ia njeh kompensimin e dëmit – fitimin e humbur në lartësi prej 27,670.74€, të shkaktuar si pasojë e mos kryerjes së punëve, gjegjësisht mos funksionalizimit të objekteve postale brenda afatit të përcaktuar me kontratë, duke minusuar shumën siç u theksua më lartë.

5. Shpenzimet e procedurës

Lidhur me kamatën ligjore, gjykata vendosi në kuptim të nenit 277 të LMD-së ashtu që obligoi të paditurin që paditësi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi të ia kompensojë së bashku me kamatë si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim

të caktuar, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, respektivisht 27.02.2014 deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që paditësit ia njohu shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës për ushtrimin e padisë shumë prej 500€, ekspertizës financiare shumë prej 700€, ekspertizës së ndërtimtarisë shumë prej 500€, ekspertizës nga lëmi i ndërtimtarisë shumë prej 600€, si dhe në emër të taksës për ankesë shumë prej 30€, në total shumë prej 2,330.00€.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.417/22, datë 25.06.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.